



Komuna Klinë

Zyra e Kryetarit të Komunës

Nr. 01

451-34045/23

Klinë, datë: 27.09.2023

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me OJQ, Biznese, Klube Sportive dhe grupe tjera të interesit, i cili u mbajt në Sallën e Konferencave, me datë 15 gusht 2023 dhe filloi në orën 18:00, ku morën pjesë: 7 persona.

RENDI I DITES

1. DRAFT PLANI I BUXHETIT KOMUNAL I KLINËS 2024 – 2026

Komuna e Klinës ka përfunduar debatet me publikun me takimin e me OJQ, Biznese, Klube Sportive dhe grupe tjera të interesit, i cili u mbajt në Sallën e Konferencave, sa i për agjendës së kryetarit të Komunës e më pas procesin e konsultimit publik do ta mbyll takimi me qytetarë në Kuvendin Komunal Klinë.

Për pikën e rendit të ditës draft-plani i buxhetit komunal i Klinës 2024 – 2026, fjalën hyrëse e mori kryetari i komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj i cili ishte i shoqëruar nga përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu, drejtori i Inspektoratit, z. Faruk Smajli, nga zyrtarja Kryesore Financiare, znj. Melihate Behramaj, drejtorë të tjerë të drejtorive si dhe grupi punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Kryetari Elezaj pasi një përshëndeti të pranishmit, bëri një prezantim të përmbajtjes së draft-buxheti për vitin 2024, u fokusua tek projektet që ndërlidhen me drejtorinë e kulturës dhe investimet që i kontribuojnë sportit në Klinë.

Pas kryetarit, përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu, ju dha fjalën pjesëmarrësve për të diskutuar lidhur ndarjen e nevojave dhe kërkesave apo edhe ndarjen e sugjerimeve që ata kanë lidhur me buxhetin e viti 2024.

DISKUTIMET DHE KËRKESART

Sejdi Desku – Përfaqësuesi i Klubit të Hendbollit të Femrave “Dukagjini”, përshëndeti të pranishmit dhe parashtrori kërkesën për rritjen e subvencioneve apo shumës buxhetore për klube në drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Shpreson që në thirrjen e ardhshme publike nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport të ketë më shumë mjete financiare sepse klubet e kanë të vështirë pjesëmarrjen në gara vendore dhe përfaqësimet jashtë vendit.



Milot Zogaj – Përfaqësuesi i biznesit "Pizza Fresh" në Klinë, kërkoi që të rritet shuma e subvencioneve për ndarjen e garantëve për bizneset në Klinë në formë të thirrjeve publike që sado pak tv ju dalin në ndihmë bizneseve duke ju ofruar kështu mundësi për bashkëfinancim në blerjen e pajisjeve të nevojshme.

Takimi përfundoi në orën 18:31.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	7
Total:	7

Procesmbajtëse:

Vlora Tafili

